

MANASTIRI I SHËN KOLLIT, MESOPOTAM

Zbulohen piktura murale të mbuluara nga llaçi dhe lyerjet me gëlqere në kishën e Manastirit të Shën Kollit në Mesopotam.

Në kuadër të projektit “Studimi për konservimin e pikturës murale, elementeve dekorative me mermer të arkitekturës dhe dyshemënë e kishës bizantine të Shën Nikollës në Mesopotam”, në zbatim të Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet MEKI dhe Qendrës Europiane për Monumentet Bizantine dhe Post Bizantine, u kryen ndërhyrje konservuese/restauruese në pikturën murale të kësaj kishe, të cilat i përkasin fazës së I-rë të punimeve të parashikuara në këtë projekt, i planifikuar të vazhdojë në vitin 2025.



KORPUSI I MOZAIKËVE TË SHQIPËRISË



Fushata në terren për projektin shkencor në vazhdim “Korpusi i Mozaikëve të Shqipërisë”, një bashkëpunim midis IKTK dhe CNRS, Paris, Francë, ka përfunduar me sukses për këtë vit. Objektivi i projektit përfshin punën mbi mozaikun e vilës së Athinasë në Parkun Arkeologjik të Apolonisë dhe mozaikun e ambientit qendror të Bazilikës B në Parkun Arkeologjik të Bylisit.

Në këta dy mozaikë, ekipi realizoi rilevimin grafik dhe ortografik me dron, dokumentoi detajet e ndryshme të strukturave, studioi teknikat e ndërtimit dhe materialet e përdorura. Po ashtu, u kryen ndërhyrje konservuese dhe konsoliduese aty ku ishte e nevojshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e këtyre mozaikëve.



KISHA E SHNA NDOUT, KEPI I RODONIT

Dalin në dritë portrete dhe figura shenjtorësh gjatë punimeve për konservimin/restaurimin e pikturës murale në **Kishën e Shna Ndout në Kepin e Rodonit.**

Punimet konsistuan në konsolidimin e shtresave përgatitore dhe pelikulit piktorik, pastrimin nga mbivëniet me gëlqere dhe llaç, pastrimin nga kripërat si dhe zëvendësimin e bordurimeve dhe stukimeve të vjetra.

Piktura murale e kësaj kishe, bashkë me atë të Kishës së Shëlbuemit në Rubik, ishin në fokusin e programit të **#EU4Culture** gjatë këtij viti për restaurimin e veprave të artit, ndërsa ndërhyrjet u realizuan nga restauratorja Edlira Çausi dhe ekipi i saj. Specialistët e Sektorit të Veprave të Artit në IKTK kanë mbikqyrur nga afër ecurinë e këtyre punimeve.

Kisha e Shna Ndout në Kepin e Rodonit është monument i trashëgimisë kulturore me një arkitekturë romaniko-gotike e shek. XIV.



REVISTA MONUMENTET



Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK), prej vitesh boton në mënyrë periodike Revistën "Monumentet". Numri i parë i kësaj reviste është botuar në vitin 1971. Vit pas viti këto botime kanë shpalosur vlerat e trashëgimisë kulturore, nga emrat më të shquar të kësaj fushe, duke bërë të mundur njohjen e këtyre vlerave të cilat janë përcjellë dhe janë mirëmbajtur me fanatizëm brez pas brezi.

IKTK dhuroi botime ndër vite të Revistës "Monumentet", Revista "Arkeologjia" etj., për **Bibliotekat e Qytetit të Tiranës, Universitetin Epoka, Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë**, me qëllim pasurimin e pasurimin e tyre dhe për të kontribuar në ruajtjen e trashëgimisë kulturore.



DITA NDËRKOMBËTARE E ARKEOLOGJISË

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Arkeologjisë, studentët e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, si dhe studentët e Fakultetit të Shkencave Sociale patën mundësinë të ndjekin prezantime nga ekspertët e IKTK-së. Një mundësi për të thelluar njohuritë rreth trashëgimisë sonë arkeologjike dhe për të diskutuar mbi rolin e saj në të ardhmen.



EKSPEDITA NË TERREN, PESHKOPI DHE RABDISHT

Specialistët e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulture vijojnë me ekspeditat në terren të cilat kanë në fokus gjurmimin e trashëgimisë kulturore në të gjithë territorin e vendit tonë.

Javën e kaluar, është realizuar vizita në qytetin e **Peshkopisë** dhe fshatin **Rabdisht**, të cilët paraqesin vlera të larta të trashëgimisë kulturore në shumë drejtime:

- Zhvillimin urban të ansamblit;
- Ndërtimet e arkitekturës vernakulare;
- Teknikat tradicionale ndërtimore, që ruhen e do të jenë objekt i studimeve të mëtejshme të IKTK për verifikimin e interesit kulturor.



ZONA ARKEOLOGJIKE, ELBASAN



Këshilli i Ministrave në mbledhjen e datës 16.10.2024, ka miratuar me 2 vendime të veçanta deklarin si Qendër Historike dhe Zonë Arkeologjike të disa zonave në qytetin e Elbasanit, mbështetur në propozimet e hartuara nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore dhe miratuar në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale.

Nëpërmjet këtij statusi mbrojtje, në përputhje me legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore, mundësohet mbrojtja, restaurimi dhe konservimi i këtyre hapësirave. Gjithashtu, i hapet rrugë rehabilitimit të orientuar dhe me kriteret të përcaktuara për zhvillim të qendrueshëm duke mbrojtur vlerat e trashëgimisë kulturore të mbitokës dhe nëntokës të qytetit të Elbasanit.



“PEIZAZHI KULTUROR NË MALËSINË E SHQIPËRISË DHE TË KOSOVËS”

Trajnimi “Peizazhi Kulturor në Malësinë e Shqipërisë dhe të Kosovës” hap një platformë për diskutime të rëndësishme mbi peizazhin kulturor dhe qasjet bashkëkohore për ruajtjen dhe menaxhimin e tij. Një nga pikat kryesore të këtij trajnimi ishte përdorimi i rilevimit ortografik me dron.

Rilevimi ortografik me dron është një metodë që shfrytëzon dronët për të kryer skanime ajrore dhe fotografi me saktësi të lartë, duke krijuar harta dhe modele tredimensionale të sipërfaqes. Kjo teknikë është thelbësore në arkitekturë, arkeologji, ndërtim, si dhe në menaxhimin e peizazheve kulturore, pasi lejon studimin e detajuar të terrenit dhe monumenteve historike.



Rilevimi ortografik me dron është një metodë që shfrytëzon dronët për të kryer skanime ajrore dhe fotografi me saktësi të lartë, duke krijuar harta dhe modele tredimensionale të sipërfaqes. Kjo teknikë është thelbësore në arkitekturë, arkeologji, ndërtim, si dhe në menaxhimin e peizazheve kulturore, pasi lejon studimin e detajuar të terrenit dhe monumenteve historike. Kjo teknikë është thelbësore në arkitekturë, arkeologji, ndërtim, si dhe në menaxhimin e peizazheve kulturore, pasi lejon studimin e detajuar të terrenit dhe monumenteve historike.

Përfitimet e rilevimit ortografik me dron:

- Saktësi e lartë
- Efikasitet në kohë
- Përgjegjshmëri ndaj mjedisit
- Akses në zona të vështira

WORKSHOP

“ATELIEJA E JANIT DHE VASILIT NGA QESTORATI NËN KUADRIN E PIKTURËS SË SHEK. XVIII”

Në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet **Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore** dhe **Institutit të Fizikës Bërthamore të Aplikuar**, me praninë e Drejtorit të Kërkimeve dhe Shefit të Labororit XRF, Z. Andreas Karydas, “Për zhvillimin e projekteve dhe veprimtarive të përbashkëta nëpërmjet përdorimit të metodave analitike e spektroskopike në fushën e trashëgimisë kulturore” e mbështetur nga **IAEA** (Agjensia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike) Vjenë, Austri, u zhvillua workshopi “Atelieja e Janit dhe Vasilit nga Qestorati nën kuadrin e pikturës së shek. XVIII”.

Prezantimet konsistuan në përfundimet e arritura mbi programin ikonografik dhe studimin e pigmenteve e materialeve të shtresave përgatitore të përdorura në realizimin e pikturave murale.



PROJEKTE RESTAURIMI

Kisha e Shën Mëri Spilesë ndodhet në afërsi të fshatrave Tranoshishtë e Saraqinishtë të rrethit të Gjirokastrës dhe në afërsi të parkut arkelologjik të Antigonesë. Në kuadër të restaurimit të kishës së Shën Mëri Spilesë janë parashikuar ndërhyrjet si më poshtë:

- Injektivim dhe qepje e çarjeve të kupolave dhe qemereve të mbulesës;
- Përforcim me fibra karboni e kupolave dhe qemereve të mbulesës;







- Përforcim i themelit të kolonave të çeduarda në të cilat mbështeten kupolat dhe qemerët;
- Restaurim i mureve të dëmtuara me teknikën e injektivimit;
- Restaurim i tirantëve prej druri;
- Restaurim i brezave antisizimik lidhës prej druri në muraturë;
- Restaurim i suvatimeve të dëmtuara;
- Restaurim i konstruksionit të mbulesës dhe çatisë.

PROJEKTE RESTAURIMI

Ndërhyrje restauruese në **banesën e z. Ëngjëll Koço me kod arkivi K-076, Lagjia Kala - Berat.**





- Restaurim çatie me material drusor;
- Restaurim strehe me tavan dërrase dhe hark të suvatuar;
- Riparim suvatimi në muraturë me skelet druri dhe lyerje me shërbet gëlqereje nga jashtë në të gjithë sipërfaqen që ka këtë muraturë;
- Heqje të fugatimit aktual të gabuar në muratur guri; fugatim i ri me llaç gëlqereje në raportin 1:3;
- Restaurim dritare druri në muraturë prej skeleti druri;
- F.V dritare druri në muraturë skelet druri;
- Trajtim me vaj lini e antimol i elementëve drusor të pamjes së jashtme të banesës (fashatuarat horizontale, kolonat e qoshes dhe strehët,dyert, dritaret etj).



PROJEKTE RESTAURIMI

Hamami i Meçites (Banjat e qytetit) është i pozicionuar në një prej pikave më të rëndësishme të referimit të peizazhit urban të qytetit të Gjirokastrës dhe është pjesë e pandashme e këtij ansambli të mrekullueshëm. Ndërhyrjet e planifikuara në projektin e restaurimit janë si vijon:




- Restaurimi i mureve të brendshëm, suvatimi dhe lyerja e tyre me gëlqere;
- Zëvendësimi i derës së jashtme prej druri me të re;
- Ndërhyrje përforcuese në kupola;
- Ndërhyrje përforcuese në themele;
- Ndërhyrje restauruese në çati;
- Restaurim i murit të gurit fasadë;
- Pastrim nga vegjetacioni përreth.



PROJEKTE RESTAURIMI

Teqeja e Baba Muharremit në Koshtan është një objekt kulti që i përket fillimit të shek. XX-të. Ndërtesa është dy katëshe. Në kuadër të projektit të restaurimit të Teqesë së Koshtanit janë planifikuar këto ndërhyrje:

- Restaurim mur guri me llaç gëlqere me teknikën shqep-qep;
- Fugatim murature në fasadë, konsolidim strukturor i muraturës prej guri;
- Injektivim i çarjeve gjatësore në muraturë me teknikën e injektivimit;
- Restaurim dysheme, shkallë druri;
- Riparim, ritukim i suvasë së brendshme të ambjenteve të ndenjës;
- Restaurim i çatisë me rrasa guri me strukturë druri;
- Përforcimi i themelit të gurit;
- Pastrim fasade mur guri, fugatim muri (pastrim mekanik + larje me ujë + fugatim);
- Pastrim i patinës biologjike në fasadën prej guri.



PROJEKTE RESTAURIMI

Manastiri i Shpërfytyrimit në Mingul, Gjirokastrë, mendohet të jetë ndërtuar në vitin 1666. Kisha është e pikturuar me teknikën e afreskut të mirëfilltë dhe mbulon absidën, naosin, kolonat, harqet, tamburin, si dhe faqen lindore të narteksit, nefet dhe kupolën. Afresket e naosit janë realizuar nga piktorët Dhimitri (II) dhe Gjergji, në vitin 1666, por ka dhe mbipikturime të mëvonëshme, të cilat kufizohen në tambur dhe në murin verior. Ndërhyrjet konservuese – restauruese në pikturën murale të kishës, konsistojnë në:

- Konsolidimi i arriccios me murin (mbushje xhepush);
- Pllobime (mbushja e lakunave ose boshllëqeve);
- Qepja e çarjeve dhe plasaritjeve të suvasë së pikturuar;
- Konsolidimi i pelikulit;
- Heqja e shtresës së blazës dhe mbetjeve vajore të qirinjve;
- Heqja e kripërave të kalciumit, kripa në formë shtrese dhe velature;
- Pastrimi i sipërfaqes së pikturës nga gëlqerja;
- Integrimi piktorik .

Depozitime të blazës mbi shtresën e pikturës murale

Po theksojmë gjithë sipërfaqen e pikturës murale në kishë e mbështetur me një vello lymë e blazë të zezë, duke sjellë në afërsisht në identifikimin dhe llogaritshmërinë e programit ikonografik.



Dëmtimi dhe rini e pelikulit

Peliku i pelikulit ka shtresë të zezë të lagështisë, konsistues me mbështetje të temperaturave, dhe përveç kësaj, dëmtimi i pelikulit.



Depozitim i njollave vajore mbi sipërfaqen e pikturës murale



Dëmtim i grundit dhe pelikulit piktorik



Gjendja e konservimit të ikonostasit të drurit



Depozitime të kripërave të kalciumit mbi shtresën e pikturës murale



Depozitime të kripërave të kalciumit.
Kripëzimi shfaqet në formën e shtresës dhe velature.



PROJEKTE RESTAURIMI

Stacioni rrugor Ad Quintum (Gërmadhat Antike), i ndërtuar në shek. II-III-të, ndodhet 5m larg gjurmeve antike të rrugës Egnatia. Ka një planimetri drejtkëndëshe me katër mjedise: dhoma e zhveshjes, mjedisi i ngrohtë, mjedisi i nxehtë, dhe ai me ujë të ftohtë. Ndërhyrjet konservuese/restauruese që propozohen janë si më poshtë:

- Konsolidim i kreut të mureve me llaç (fugatim);
- Konsolidim i frakturave dhe çarjeve në kupolë;
- Kapuçim i kreut të murit me tapet bari;
- F.V. tiranta metalik inoksidabël;
- Çati e re dhe vendosje e ullukëve të shkarkimit;
- Zbarkim dherash dhe drenazh me kunetë guri dhe llaç hidraulik;
- Pastrim nga bimësia.





PROJEKTE RESTAURIMI

Banesa e Oso Kukës në Shkodër është pasuri kulturore me status monument kulture i kategorisë së I-rë, datë 08.01.1977. Ndërtimi i banesës mendohet se i përket shekujve XVIII-XIX.

Në kuadër të projektit për restaurimin dhe mirëmbajtjen e Banesës së Oso Kukës, janë planifikuar ndërhyrjet si më poshtë:



- Restaurim mur guri me teknikën e injektimit;
- Suvatim i jashtëm;
- Restaurim i çarjeve në muraturë;
- Restaurim i çatisë dhe strehës së çatisë;
- Restaurim derë dhe dritare druri.



PROJEKTE RESTAURIMI

Xhamia e Allajbegisë në fshatin Burim, Maqellarë, është shpallur Monument Kulture i Kategorisë së I-rë në vitin 1970. U ndërtua në shek. XVI-të dhe konsiderohet me vlera të spikatura nga pikëpamja ndërtimore. Në kuadër të projektit për restaurimin e xhamisë, janë planifikuar ndërhyrjet si më poshtë:

- Riparim, suvatim, retukim i pjesëve të dëmtuara të suvasë me llaç-gëlqere;
- Izolim i kupolës dhe vendosje e tjegullave të vendit;
- F.V. dyer e dritare sipas modelit ekzistues;
- Pastrim vegjetacioni.







PROJEKTE RESTAURIMI

Ura e vogël tek Gurrat e Kodrës, Mat, është një urë me një hark të vogël. Për ndërtimin e saj janë përdorur dy lloje të ndryshme gurësh. Harku i urës është ndërtuar me gurë shtufi. Teknikisht ruhet në gjendje të mirë, por ka nevojë për ndërhyrje pasi degradimet në struktura e saj janë evidente; si mungesë gurësh, bimësi në muret e saj dhe mungesë kalldrëmi.

Në kuadër të projektit për restaurimin e urës, janë planifikuar ndërhyrjet si më poshtë:

- Injektim, fugatim me llaç hidraulik muratures;
- Konsolidimi i plasaritjeve dhe mbushja e boshllëqeve;
- Restaurim i kornizës me gur, plotësim sipas teknikës origjinale;
- Pastrim mekanik i vegjetacionit dhe patinës biologjike.








PROJEKTE RESTAURIMI

Ura e Gurit të Hoxhës ndodhet ndërmjet lagjes së qendrës dhe lagjes Hoxhaj, Gurë i Bardhë, Klos. Këmbët e urës janë të vendosura mbi brigje të ulta shkëmbore. Thuhet se urën e ka ndërtuar Mehmet Hoxha para 250 vitesh. Ura përbehet nga një hark i vetëm.

Në kuadër të projektit për restaurimin e urës, janë planifikuar ndërhyrjet si më poshtë:

- Injektim, fugatim me llaç hidraulik muraturës;
- Konsolidimi i plasaritjeve dhe mbushja e boshllëqeve;
- Pastrim mekanik i vegjetacionit dhe patinës biologjike;
- Restaurim dhe plotësim i shtresës së kalldrëmit sipas modelit original.






PROJEKTE RESTAURIMI

Banesa e Temo Çelajt në fshatin Klos, Mallakastër është e ndërtuar me 2 kate, me muraturë guri lidhur me llaç. Në anën veriore, ku kalon dhe rruga, ka një rrethim me mur guri nga ku hyhet për në oborr të banesës. Ndërtimit fillestar më pas i është shtuar dhe një pjesë tjetër nga prapa banesës, po me dy kate. Banesa është e mbuluar me çati me strukturë druri dhe mbuluar me tjegulla vendi.

Për shkak të dëmtimeve shumë të mëdha, banesa do t'i nënshtrohet ndërhyrjeve restauruese:

- Plotësim i mureve të shembur me muraturë guri lidhur me llaç;
- Plotësimi i suvatimeve të brendshme;
- Injektivim, fugativim me llaç sipas modelit ekzistues;
- Plotësimi me dysHEME druri;
- Pastrim i bimësisë nga patina.



VLERËSIMI I PARKUT ARKEOLOGJIK BYLIS (QYTETET ANTIKE BYLIS DHE KLOS)

1. Objektivi i përgjithshëm i projektit:

Ruajtja dhe përmirësimi në përdorimin dhe atraktivitetin e aseteve të trashëgimisë kulturore në Parkun arkeologjik të Bylisit.

2. Projekti ka si objekt të punës:

- Ndërtimin e një qendre multifunksionale për vizitorët në Parkun Arkeologjik të Bylisit përfshirë zyrën e biletarisë;
- Një masterplan me itineraret turistike për pikat më të rëndësishme arkeologjike, historike dhe natyrore të shoqërura me interpretimet për monumentet dhe pikat e interesit në Park;
- Propozime për rregullimin e hyrjes, gardhin e sigurisë, zgjidhjen e mbrojtjes aktuale të monumenteve për sitet e Bylisit dhe Klosit;
- Parkimin e automjeteve për vizitorët.




KIOSKË SHËRBIMI NË HADRIANOPOL

Hadrianopoli është qytet i periudhës antike dhe mesjetare, gërmadhat e të cilit janë zbuluar afër fshatit Nepravishtë në Gjirokastrë.

Në kuadër të rrethimit të teatrit antik të Hadrianopolit, është propozuar ndërtimi i një pike shërbimi, e cila në perspektivë do të shërbejë edhe si pikë biletarie.

- Skeleti do të jetë i lehtë me material prej druri dhe kolona guri 50x50x100 cm, ku gjysma e tyre do të jetë e zhytur dhe pjesa tjetër mbi sipërfaqe.
- Mbi katër kolonat do të vendoset një platformë prej trarësh dhe dërrasa druri.
- Muret përbehen nga kollona druri 8x8 cm të veshura me dërrasa pishe.



TABELAT INFORMUESE PËR MONUMENTET (QENDRA HISTORIKE BERAT)



Pozicioni i monumenteve në lidhje me qytetin



Tabela Kisha e Shën Mari Villahernës
(Gjendja Ekzistuese)



Tabela Kisha e Shën Kollit
(Gjendja Ekzistuese)



KISHA E PROFETIT ILIJ

Kisha e Profetit Ili është një ndërtesë e tipit bazilikal dhe mund të jetë e gjatë, e ndërtuar në vitin 1922. Ajo ishte e përbërë nga nartek, narthek, hapësirë e krahut, kor, kisha dhe fundi i kishës. Ndërtesa e kishës është e zbukuruar me piktura murale në tërësi gjatë vitit 1922. Kjo pikturë mund të jetë realizuar në vitin 1922, me skemë të ndërtimit nga arkitekti bishop dhe figura shpirtërore. Shkrimet brenda kishës tregojnë se kisha është ndërtuar gjatë viteve të fundit të shekullit të 19-të dhe fillimit të shekullit të 20-të. Kjo kisha është e ndërtuar në qendër të qytetit. Të gjithë qendrat e kishës janë të ngjashme.

Përdorimi i materialit në vitin 1922, ka treguar se Kongresi i Beratit të Kishës Ortodokse Autoqefale Kombelesh të Shqipërisë, mbajtur më 1922. Gjate periudhës komuniste, kisha u përdor si qendër ushtarake, ndërsa në vitin 2021, ajo është shpallur monument kulturor.

CHURCH OF PROPHET ILIJAH

The Church of Prophet Ili is a basilican building and may belong to the second half of the 19th century. It was composed of the nave, the narthex, the porch and the bell tower, but the latter two do not exist today. The interior of the church is decorated with mural paintings along its entire length. This painting may have been made in 1922, with scenes inspired by biblical texts and figures of saints. The writings inside the church speak of those of the saints are written in the Albanian language, except for a small-sized writing made in Greek, which is found in the scene of the Evangelists.

The use of inscriptions in the Albanian language is related to the Berat Congress of the National Autocephalous Orthodox Church of Albania, held in September 1922. During communism, the church was used as a military shelter, while in 2001 it was declared a protected cultural monument.




KISHA E PROFETIT ILIJ
CHURCH OF PROPHET ILIJAH

Tabelat e reja të propozuara



KISHA E SHËN TRIADHËS

Kisha e Shën Triadhes paraqet ndërtimin më të vjetër të kishës kryesore në Berat. Ajo është e ndërtuar në vitin 1922, me skemë të ndërtimit nga arkitekti bishop dhe figura shpirtërore. Kisha është e ndërtuar në qendër të qytetit. Të gjithë qendrat e kishës janë të ngjashme.

Përdorimi i materialit në vitin 1922, ka treguar se Kongresi i Beratit të Kishës Ortodokse Autoqefale Kombelesh të Shqipërisë, mbajtur më 1922. Gjate periudhës komuniste, kisha u përdor si qendër ushtarake, ndërsa në vitin 2021, ajo është shpallur monument kulturor.

CHURCH OF SAINT TRIADHA

The Church of Saint Triadha represents the perfect construction of the medieval stone church of the provincial type, with two chapels and columns as internal support. In Berat, it preserves the only traces of the Byzantine period, with paintings in the nave and in the narthex. The fresco is a contemporary painting with the equivalent paintings that were created in Byzantium during the end of the 12th century. The location of the church, near the second walls of the castle and its dimensions, prove the hypothesis that it must have been built by the rulers of Berat at the end of the century. According to the inscription located on the southern lower side of the narthex translated by Theodor Popa, it appears that the monument of Saint Triadha in Berat was built during the reign of Andronikos Palaiologos without his father from 1202-1203. The painting of the wall was more likely done immediately after the construction.





KISHA E SHËN TRIADHËS
CHURCH OF SAINT TRIADHA

Tabelat e reja të propozuara